



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAÇANIKUT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCË
07 Nr. 104/02 – 6434/24
Kacanik 02.05.2024



NJOFTIM

Referuar dakordimit të përbashkët mes Komunës së Kaçanikut dhe kompanisë G.C.F (Generale Construzioni Ferrovarie S.p.A), kompani përgjegjëse për realizimin e projektit "Rehabilitimi i linjës hekurudhore Fushë Kosovë-Hani Elezit", me qëllim të zhvillimit të punimeve në tunelin hekurudhor afër "Gurit të Shpumë"-Kaçanik, nga data 02.05.2024 do të bëhet mbyllja e përkohshme e rrugës magjistrale Kaçanik-Hani Elezit.

Me këtë rast:

- Rruga "Agim Bajrami" dhe "Idriz Seferi"-Kaçanik do të përdoren si rrugë alternative për qarkullim të automjeteve me pesha të lehta dhe autobusëve të transportit publik të udhëtarëve në drejtimin Kaçanik-Hani Elezit dhe anasjelltas.
- Automjetet me pesha të rënda, për këtë drejtim, do të shfrytëzojnë segmentin e autoudhës "Arbër Xhaferi".

Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, brenda kompetencave të saja, do të angazhohet në vendosjen e shenjësimit vertikal (shenjave të ndalesave të prera, shenjave njoftuese, ndryshimin e rrjedhës së lëvizjes dhe shenjave tjera të nevojshme) për orientim dhe lehtësim të qarkullimit të automjeteve në këto rrugë.

Kompania G.C.F (Generale Construzioni Ferrovarie S.p.A), krahas vendosjes së tabelave njoftuese, do të merr përsipër sanimin e dëmtimeve eventuale në infrastrukturën rrugore.

Ju falënderojmë për mirëkuptimin tuaj.

Me këtë shkresë njoftohen:

- Stacioni i Policisë-Kaçanik
- Inspektorati komunal
- Arkivi

Ramadush Osmani
Drejtore i DSHPE-së